


# TË PËRKUSHTUAR NË PUNËN QË BËJMË



## SOT UDHËHEQIM NE

FJOLLA (15), LEONDRIT (14), ELIONA (14), BELTINA (15)



**Vite më parë, shtetet me qeverisje demokratike nuk kanë funksionuar njësoj siç funksionojnë tani. E si funksionojnë sot këto shtete, e kuptoni në vazhdim**

Po e fillojmë këtë artikull me një të vërtetë. Në kohën kur ka lindur demokracia, ajo ka qenë e mangët për sa i përket të drejtave të barabarta të qytetarëve.

Në kohën kur është paraqitur demokracia, pabarazia në mes qytetarëve ka qenë shumë e theksuar, e sidomos pabarazia gjinore. Shtesa e pasur e ka pasur në dorë pushtetin, kurse shtesa e varfër ka qenë e shlytur dhe pa të drejta. Ne ndjejmë njëkohësisht edhe keqardhje por edhe gëzim, sepse e kaluara ka qenë vërtet e dhimbshme për ata të cilët e kanë përjetuar këtë padrejtësi. Por, neve na mban të gëzuar fakti se ne tani jetojmë të lirë dhe çdonjëri prej nesh i kemi të drejtat tona.

Dy dekada më parë, Kosova ka qenë në një gjendje të palakmueshme. Kjo sepse kemi qenë në konflikt me shtetin e Serbisë. Pasojë e atij konflikti ka qenë izolimi i qytetarëve dhe frika për të lëvizur lirshëm. Por, kjo gjë ka ndryshuar me shpalljen e Kosovës shtet demokratik në vitin 2008. Tani ne lëvizim lirshëm, jetojmë në paqe e mirëkuptim dhe me shumë respekt për njëri-tjetrin, sepse të fillë na ka bërë demokracia. Domethënia e fjalës demokraci është udhëheqje e popullit. Fjalë kjo e cila rrjedh nga greqishtja e lashtë. E mira e kësaj forme të qeverisjes është se ajo nuk ka

mbetur vetëm në Greqi, por ajo është përhapur edhe në shumë shtete të botës, duke përfshirë edhe shtetin tonë.

Ne sugjerojmë për ju që e lexoni këtë artikull të njohetoheni sa më shumë për demokracinë si koncept dhe me të drejtat të cilat ne i kemi krahas saj. Në atë mënyrë ju do t'i arrini më lehtë qëllimet e juaja. Lëvizja e lirë, shprehja e lirë e mendimeve, e drejta e familjes e shumë të drejta të tjera, na plotësojnë neve dhe na bëjnë qytetarë demokratikë.



**Udhëheqës të shtetit tonë jemi ne qytetarët**



Në këtë vizatim është paraqitur një qytetar i përgjegjshëm, i cili i respekton ligjet



Kosova u shpall shtet i pavarur dhe demokratik më 17 shkurt 2008



Demokracia, çdo herë kur përmendet, të kujton lirinë, paqen, barazinë, të drejtat e njeriut, etj. Këto për ndryshe janë edhe elementet kyçe të demokracisë



Duke qenë e ardhmja e vendit, punuam me shumë përkushtim në artikullin tonë




Gjatë punës në grup, kuptuam sa është i rëndësishëm bashkëpunimi me njëri-tjetrin

## ZGJEDHJET SJELLIN NDRYSHIM

BLINOR (15), RIDVAN (14), RINESA (15), RIGON (14), MAGDALENA (14)

**Pa të drejtën e votës dhe pa zgjedhje të lira, demokracia nuk do të kishte kuptimin që sot e ka. Sepse, çdo ndryshim i mundshëm fillon me zgjedhje të lira dhe transparente**

Demokracia si sistem i qeverisjes ka disa elemente që e bëjnë të dallohet atë nga sistemet e tjera. Si një prej tyre dhe gati më e rëndësishmja është e drejta e votës. Të drejtën e votës së lirë e gëzojnë të gjithë qytetarët që nga moshë 18 vjeçare. Kjo moshë vlen për vendin tonë, dhe për disa vende të tjera evropiane, sepse ka edhe shtete që të drejtën e votës e fitojnë kur të arrijnë moshën 16 vjeçare. Kur themi të gjithë qytetarët, nënkuptojmë këtu çdo individ që është shtetas i Kosovës, pa marrë parasysh etninë, kombin, fenë, etj. Në demokraci dallimet nuk duhet të ekzistojnë kur është fjala për të drejtat. Prandaj, të gjithë duhet të trajtohenmi të barabartë dhe të mos bëjmë dallime asnjëherë. Përkundrazi, t'i respektojmë të drejtat e njëri-tjetrit.



**Këtu kemi paraqitur disa qytetarë të shteteve të ndryshme, të cilët e gëzojnë të drejtën e votës dhe e shfrytëzojnë atë**



**Të votosh është përgjegjësi**

Duhet të cekim se edhe pse këto zgjedhje kanë dallime mes vete, prapëseprapë rëndësia e të dyjave është shumë e madhe. Zgjedhjet janë një nga disa format që qytetarët mund ta shprehin lirshëm fuqinë e tyre. Por, po ashtu ata mund të shprehin edhe bindjet e tyre politike. Arsyeja pse themi kështu është sepse qytetarët ua besojnë votat personave për të cilët mendojnë se janë të duhurit. Në rast se një gjë e tillë nuk ndodh, atëherë në zgjedhjet e radhës, qytetarët nuk i votojnë ata persona të cilët nuk i kanë përmbushur premtimet e dhëna gjatë fushatës parazgjedhore. Prandaj themi, ndryshimi vie nga votat tona. Kujdesi duhet të jetë i shtuar dhe ne duhet të jemi gjithmonë syhapur.


Qytetarët e vendit tonë marrin pjesë në dy lloje të zgjedhjeve, në zgjedhjet qendrore dhe ato lokale. Kur mbahen zgjedhjet lokale, të gjithë qytetarët që janë mbi moshën 18 vjeçare e kanë përgjegjësi të dalin dhe t'i votojnë përfaqësuesit e tyre, që janë: kryetari i komunës dhe asamblistët. Detyrat dhe përgjegjësitë e kryetarëve dhe asamblistëve janë t'u përgjigjen kërkesave të qytetarëve, si dhe të punojnë në të mirë të asaj komune. Secila komunë zgjedh përfaqësuesit e vet. Kurse, tek zgjedhjet qendrore qytetarët nga mbarë Kosova i votojnë kandidatët për deputetë. Pra, dallimi i tyre është se një lloj i zgjedhjeve ndodh në nivel komunal, kurse tjetri në nivel qendror.



**Nxënësit e shkollës „Dëshmorët e Baballoqit“**

# KUVENDI, INSTITUCION LIGJVËNËS

GENTOART (16), ELVISA (14), LULJETA (14), FJOLLA (15), MENDIM (14)



**Shpesh kemi dëgjuar për Kuvendin e Kosovës, por sot patëm mundësi të diskutonim më shumë rreth tij. Në këtë artikull i kemi shkruar disa fakte dhe shembuj se si Kuvendi ndikon në jetën tonë**

Në demokraci, ne si popull i kemi të drejtat e barabarta, pa dallim moshe, gjinie, race, etniciteti, etj. Këto të drejta i kemi të garantuara me ligj. Ligjet janë rregulla të cilat duhet të respektohen. Qytetarët e përgjegjshëm, e dinë rëndësinë e këtyre ligjeve, dhe i respektojnë ato.

Për shkak që vendimet për ligje merren në Kuvendin e Kosovës, ndryshe ky institucion njihet edhe si „Institucioni Ligjvënës“. Deputetët të cilët i zgjedh populli, marrin vendime duke i votuar ligjet në Kuvend. Mbledhjet të cilat deputetët i mbajnë zakonisht të enjteve, ndryshe njihen edhe si seanca plenare.

Numri i deputetëve në Kuvendin e Kosovës është 120, ku 100 prej tyre i përkasin kombësisë shqiptare, kurse 20 të tjerë janë nga komunitetet jo shumicë, si: romë, ashkali, egjiptianë, turqë, boshnjakë, serbë dhe goranë. Duke pasur parasysh që barazia është element kyç në demokraci, 20 vende, pra, janë të garantuara për komunitetet jo shumicë.

Rëndësia e Kuvendit si institucion është shumë e madhe, sepse struktura e jetës tonë, varet nga vendimet që merren aty. Për shembull, e drejta jonë e shkollimit, është e garantuar me ligj dhe ky ligj na mundëson të gjithëve që të shkollohemi, pa dallime. Po të mos

ishite vendosur kështu, vetëm një pjesë e vogël e qytetarëve do të shkollohej.

Duke e parë rëndësinë e vendimeve, populli duhet të jetë mjaft i kujdesshëm se kë e zgjedh si përfaqësues. Por, mundësia tjetër e mirë është që mandati i deputetëve është 4 vjeçar. Gjatë kësaj kohe nëse deputetët janë të denjë për punën e tyre, populli përsëri do t'i votojë të njëjtit. Kurse, nëse ata marrin vendime jo të përshtatshme për popullin, në mandatin tjetër duhet të zgjedhen kandidatët të tjerë për deputetë.

Pra, neve si qytetarë të Republikës së Kosovës na takon që të punojmë për të mirën e vendit tonë.



**Ne jemi grupi „Ardhmëria“, që e kemi shkruajtur këtë artikull për ju. Shpresojmë se informatat që i gjeni këtu dhe vizatimet që i kemi bërë do t'iu pëlqejnë, juve të dashur lexues**



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Dëshmorët e Baballoqit“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Baballoq, Deçan